



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
SENATI AKADEMIK

Nr. 1092 / Prot.
14

Gjirokastrë, më 08 / 09 / 2020

STRATEGJIA E UGJ
PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN

(Miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08 / 09 / 2020, të Senatit Akademik të UGJ-së)



Universiteti "Eqrem Çabej", realizimin me sukses të misionëve të tij e lidh ngushtësisht dhe me procesin e *Ndërkombëtarizimit*, i vlerësuar si një dimension prioritar për zhvillimin.

Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë përcaktohet si procesi i integritit në dimensionin ndërkombëtar të kërkimit shkencor, mësimdhënie/mësimnxënies etj. Gjeografia e bashkëpunimit ndërkombëtar të UGJ-s përfshin një gamë të gjërë universitetesh në Evropë, Azi, SHBA, etj.

QËLLIMI

UGj ka si qëllim: zgjerimin dhe konkretizimin e marrëdhënieve në të gjithë format e bashkëpunimit ndërkombëtarë me IAL dhe institucionet e tjera kërkimore-shkencore, në funksion të pjesëmarrjes aktive në projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta, realizimit të programeve të përbashkëta, nxitjes së shkëmbimit të stafit akademik dhe jo-akademik, etj.

OBJEKTIVAT:

1. Të zgjerojë dhe konkretizojë në vijë mësi Marrëveshjet e Bashkëpunimit bilateral;
2. Të orientojë me profesionalizëm drejtimit e Bashkëpunimit Ndërkombëtar;
3. Të zgjerojë përfshirjen në programe studimesh dhe projektet kërkimore-shkencore të përbashkëta të stafit akademik dhe studentor me universitetet partnere;
4. Të organizojë dhe ofrojë diploma të përbashkëta me universitetet partnere, në kuadrin e marrëveshjeve dhe programeve të studimit me interes të përbashkët,

Format dhe drejtimit e Ndërkombëtarizimit në UGJ:



A. Bashkëpunimi me IAL-të dhe Institucionet e Kërkim-zhvillimit, me synimin që të bëhet pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave kërkuese universitare të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, Europës Juglindore, OCDE-së etj, mbi bazën e ;

1. marrëveshjeve të nënshkruara midis tyre, me synim përshirjen e stafit akademik dhe jo-akademik në programet e mobiliteteve, në projekteve kërkimore, etj;
2. angazhimit të pandërprerë për rritjen e cilësisë dhe konkretizimit të bashkëpunimit;
3. angazhimit për zgjerimin e këtij bashkëpunimi në projekte të përbashkëta, etj.

Ky bashkëpunim krijon mundësi:

- kontakti për stafin akademik dhe jo-akademik;
 - mobiliteti dhe kualifikimi;
 - kualifikimi të stafit akademik;
 - ristrukturimi të kurrikulave, etj.
4. angazhimit efektivisht duke aderuar në rrjete dhe shoqata ndërkombëtare të edukimit dhe kërkimit (si BUA, IAU, CUM, etj ku jemi të anëtarësuar);
 5. organizimit të aktiviteteve të përbashkëta (konferenca ndërkombëtare shkencore, kongrese, workshop-e,), realizimin e botimeve në fusha të interesit të përbashkët, etj.
 6. angazhimit në projekte akademike dhe kërkimore-shkencore, për ngritje kapacitetesh nëpërmjet Erasmus +, Horizont 2020, etj,

Angazhimi në këto projekte kontribuon në:

- rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor;
- diversifikimin e burimeve të të ardhurave;
- rritjen e kapaciteteve infrastrukturore (në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor);
- promovimin e kooperimit ndërkombëtar, etj

B. Bashkëpunimi për Ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe kërkimit nëpërmjet:

1. organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta me universitetet partnere;
2. hartimit të programeve të studimore në gjuhën angleze (në funksion të këmbimit të stafëve akademike dhe studentore);



3. organizimit dhe funksionimit të shkollave ose kurseve verore; angazhimit të stafëve respektive, si ekspertë, konsulentë shkencorë në programe doktorate, rivieë, projekte shkencore etj.

C. Zgjerimit të kapaciteteve të IRO dhe MP

Efektshmëria e procesit të *Ndërkombëtarizimit* lidhet drejpërdrejtë me kapacitetin e stafit të sektorit të *Marrëdhënieve me Jashtë (IRO)* dhe *Menaxhimit të Projekteve (MP)*.

Në këtë kontekst nevojitet:

1. Rritja dhe zgjerimi i kapaciteteve të IRO dhe MP si dhe forcimi i rolit të tyre;
2. Hartimi i rregullores për menaxhimin e mobiliteteve, transferimin e kredive (ngritja e komisioneve përkatëse për këtë qëllim);
3. Hartimi i një kalendari takimesh informuese mbi :
 - procedurat e mobiliteteve (ndonëse shfaqen dhe në ëeb-in e universitetit);
 - aktivitetet e organizuara nga zyra e Erasmus + , Horizont 2020, Ambasadat e huaja mbi thirrjet e lëshuara, për aplikime në programe të ndryshme të financuara prej tyre, etj.
 - takimet me studentët përfitues (të përfshirë) në këto programe, për të ndarë eksperiencat e përfituara;
 - organizimi I “Ditëve të Mirëseardhjes” për pedagogët dhe studentët e huaj, etj.
4. Pasqyrimin në kohë reale në faqen zyrtare të UGJ, të thirrjeve për aplikime në programet e mobilitetit dhe projekteve.

Nisur nga rëndësia që ka *Ndërkombëtarizimi*, këtij procesi duhet t’i atribuohen burimet e nevojshme dhe të qëndrueshme materiale, financiare dhe njerëzore. Vetëm në këtë mënyrë përfitimet potenciale mund të kthehen në përfitime reale.

